



ARGUMENTUM

news opinion analysis



**Përvjetori i parë i emërimit
Arqipeshkv në krye të Kishës
Katolike/ Mons. Arjan Dodaj:
Vetem Zoti mund të jetë
autori i ecjes sonë**

-Moment historik!
Udhëheqësit e Kosovës
nënshkruan kërkesën
për anëtarësim në BE

- "Korrupsioni Gërryen Poten-
cialin e Shqipërisë" - Ambasa-
dorja e SHBA-së Yuri Kim

- Dialogu në "koma artificiale"!

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 INTERVISTA

- Përvjetori i parë i emërimit Arqipeshkv në krye të Kishës Katolike/ Mons. Arjan Dodaj: Vetëm Zoti mund të jetë autori i ecjes sonë!

09 REALPOLITIK

- Dialogu në “koma artificiale”! Katari futbollistik, katran demokratik! Klima midis krizës dhe katastrofës! Ballkani i Hapur” non – grata” dhe në Bruksel!

12 EDITORIAL

- “Korrupsioni Gërryen Potencialin e Shqipërisë”

14 JO VETËM LAJM

- Bosnje-Hercegovinë: Vend kandidat i BE falë gjeopolitikës

15 FOKUS

- Zgjidhet kreu i ri i SPAK/ Ambasadorja Amerikane ndjek procesin nga afër

17 RAJONI

- Moment historik! Udhëheqësit e Kosovës nënshkruan kërkesën për anëtarësim në BE.

- Vuçiq: Do t'i dërgojmë KFOR-it kërkesën për kthimin e trupave në Kosovë.

- MALI I ZI NË QORRSOKAK

ENGLISH EDITION

22 INTERVIEW

- The first anniversary of the appointment as Archbishop at the head of the Catholic Church/ Mons. Arjan Dodaj: Only God can be the author of our walk!

25 IN FOKUS

- Kim reveals she would stay longer as US Ambassador to Tirana despite expiry of her mandate

26 TOP NEWS

- Berisha's warning to Rama: A man may be killed, but the cause never dies!



“Të rizbulojmë paqen, atë që nuk po arrijmë ta kemi në Ukrainë por të paktën ta vlerësojmë e ta thellojmë midis nesh këtu në Shqipëri”

Përvjetori i parë i emërimit Arqipeshkv në krye të Kishës Katolike/ Mons. Arjan Dodaj: Vetem Zoti mund të jetë autori i ecjes sonë!

Intervistë Ekskluzive për Argumentum.al me Arqipeshkvin e Arqidioqezes Tiranë-Durrës, Mons. Arjan DODAJ



Intervistoi: MARJANA DODA

Arqipeshkvi Metropolitan i Tiranë – Durrës, Imzot. Arjan Dodaj në një intervistë ekskluzive për Argumentum.al, flet për rrugëtimin e vitit të parë si Arqipeshkv në krye të Kishës Katolike që kur Papa Françesku e shpalli zyrtarisht më 30 Nëntor 2021.

“Ka qenë një udhëtim sa i gjatë por në të njëjtën kohë shumë i shkurtër, pothuajse kaloi viti pa kuptuar. Megjithatë duke ndalur pak “klepsidren”, për të mos lejuar që rëra të zbresë pa lënë gjurmë në ekzistencën time, shoh në të vërtetë që ky hark viti, ka qenë një viti i bekuar plot hire

që kanë lënë gjurmë në fytyrat e zemrat e shumë njerëzve që kam takuar”, shprehet Imzot Dodaj.

Megjithatë rrugëtimi i tij religjioz ka filluar shumë herët që me largimin e tij nga Shqipëria si emigrant drejt Italisë pas viteve 90-të.

“Vetëm Zoti mund të jetë autori i ecjes sonë. Unë kurrë se kam imagjinuar që do bëhesha prift, por ja që në takimin me një përvojë të gjallë të fesë kam takuar fenë në personin e Jezu Krishit”, thotë Imzot Dodaj

“Në etapat historike të ekzistencës tonë, janë disa data e disa momente që mendojmë që i zgjedhim ne, por në të vërtetë Zoti

i ka bërë ato të rëndësishme për ne. Përshebull, më 30 Nëntor të vitit 1997 kam hyrë në seminar kur kam filluar jetën time në formimin për meshtar në komunitet. Dhe më 30 Nëntor 2021 është publikuar emri im si Arqipeshkv. Pra ja gjëra që Zoti në njëfarë mënyre në historinë e secilit prej nesh i shënon që historia jonë të mos jetë thejsh një histori kalimtare njerëzore por të bëhet me të vërtetë një histori hyjnore për amshim”.

Duke renditur disa nga ngjarjet më të rëndësishme të këtij viti për të në krye të Kishës Katolike, Imzot Arjan Dodaj flet për festivalin e madh të Lutjes dhe Paqes me pjesmarrjen pa dallim

feje e ideje të qindra të rinjve e të rejave dhe jo vetëm. Nisur dhe nga thirrjet për paqe në Ukrainë, Imzot Dodaj thotë se: “Ukraina është vetëm një valvul shfryrje e një konteksti që siç thotë Papa Françesku të një lufte të tretë botërore që është e ndare në pjesë në mbarë globin”.

“Përvoja e paqes dhe përvoja e lutjes është një përvojë bekimi për çdo njeri të çdolloj feje qofte ai, dhe kjo përvojë atë ditë u perceptonte në mënyrë të gjallë falë edhe momentit të lutjes, momentit të bashkëndarjes edhe të njerit prej këtyre që vijnë nga përvoja e Medjugores ku në 1981 Zoja ka filluar ti deftojë Ivan Dragicevic. Kjo përvojë lutjeje për mua ka qenë nxitëse që në momentin e parë kur Papa Françesku duke parë ngurtësinë dhe shkretëtirën e përgjigjes së liderve botërore për paqen që në fillim në Ukrainë, atëherë ai bëri një apel ndaj gjithë Kishës, por jo vetëm Kishës, ndaj të gjithë njerëzve vullnetmirë që të mbledheshin me 25 Mars e të bënin këtë akt kushtimi ndaj virgjëres Mari për të kërkuar paqen”.



Një moment tjetër tejet i veçantë dhe i emocionues është Përkujtimi i 70-Vjetorit të Meshës së Pashkëve në Tepelenë të kremtuar nga 5

priftërinj katolikë në 1952, dhe njëkohësisht udhëheqjen e meshës së Shenjtë në ambientet e ish-burgut të Spaçit, në Mirditë.

“Ka qenë me të vërtetë një përvojë e një kremtimi në ferr ku sundon dhe fiton Drita, sundon dhe fiton Jeta”, thotë Arqipeshkvi Arjan Dodaj.

Sa i përket një fenomeni shqetësues që po bëhet prezent gjithnjë e më shumë vitet e fundit në Shqipëri siç është largimi i të rinjve Imzot Dodaj thotë:

“Fatkeqësisht brezat e rinj por jo vetëm të të rinjtë, por te shumë familje kërkesa apo pyetja e parë që njerëzit përpiqen ti japin përgjigje është fakti i një zhvendosje nga këtu. Fakti i një kërkimi te një stabiliteti gjetke, gjithmonë jashtë Shqipërisë. Kjo është shumë dramatike. Pse, sepse na bën të harrojmë vetëdijen se asnjë nuk e njih akoma vendin e vet dhe asnjë nuk e njih akoma mirë popullin e vet. Fenomeni i emigrimit është fenomen që i përket natyrës njerëzore,

ka ekzistuar që në kohët e lashta, dhe vetë libri i Shenjtë është i mbushur plot me to. Por përshembull në librin e shenjtë kemi dhe fenomenin e kthimit.

Eksodi...Mendoj se siç thashë mungon informacioni nga njëra anë, pra për të parë se çfarë po kërkojmë andej dhe për të ditur se çfarë do të gjejme realisht.

Dhe e dyta mungojnë sigurisht dhe politikat nxitëse te një rritje me të madhe të nivelit të jetesës”

Ndërsa lidhur me familjen, Imzot Dodaj thotë se Familja është një realitet që ne e kemi marrë si dhuratë nga Zoti.

“ Familja ekziston pavarësisht ideve tona dhe është ajo natyrale, që është e themeluar në Babain dhe Nënë, burrin dhe gruan, që janë pikërisht ata që janë të thirrur për të rithemeluar jeten, për ti dhënë vazhdimësinë gjinisë njerëzore. Kjo është shumë themelore sepse po humbëm këtë abc nuk mund të vijojmë dialogun për të ardhmen e shoqërisë, për të ardhmen e njerëzimit. Një aspekt tjetër shumë themelor është të kthehemi te fakti që një familje ka nevojë të ketë një mbështetje që të jetë familje, përndryshe ne rrezikojmë me të vërtetë të kemi familje që fatkeqësisht janë shumë të mjera, të sprovuara, të shtypura, të harruara.”

Sa i përket politikës dhe politikaneve, kreu i Kishës Katolike ka një mesazh për të gjithë politikëbërësit. Politika shqiptare duhet të zbulojë që nuk është një investim të futesh në politikë por është një shërbim siç thoshte Pali VI-të, që politika është mënyra më e larte e dashurisë.

“Politika shqiptare ka nevojë që të kuptojë që vlerat për të cilat është e thirrur që ti mbroje nuk niset nga interesi monetar por mbi të gjitha nga interesi më i madh, që është atij i kombit, i vendit. Interesi i kombit shkon mbi interesat individuale”, thotë Arqipeshkvi Metropolit i Tiranë-Durrës, Mons. Arjan Dodaj.

INTERVISTA E PLOTË

-Argumentum.al: I nderuar Imzot Dodaj, faliminderit për këtë intervistë e cila zhvillohet në kuadrin e përvjetorit tuaj të parë si Arqipeshkv që nga emërimi Juaj nga Papa Françesku më datë 30 nëntor, 2021. Si ka qenë për ju ky rrugëtim përgjatë këtij viti si Arqipeshkvi i ri Metropolitan i Tiranë-Durrës?

Imzot. Arjan Dodaj: Faliminderit juve, para së gjithash që gjetët kohën dhe mundësinë, por në të njëjtën kohë nxitjen për të zhvilluar këtë intervistë.

Ka qenë një udhëtim sa i gjatë por në të njëjtën kohë shumë i shkurtër, pothuajse kaloi viti pa kuptuar. Megjithatë duke u ndalur, duke reflektuar, duke ndalur pak “klepsidren”, për të mos lejuar që rëra të zbresë pa lënë gjurmë në ekzistencën time, të shoh në të vërtetë që ky hark viti, ka qenë një viti i bekuar plot hire që e shoh që kanë lënë gjurmë në fytyrat e zemrat e shumë njerëzve që kam takuar. Mendoj, shpresoj se kam perceptuar veçanërisht për mirë. Përpiqem që me ndihmën e të gjithëve të japi këto efekte në kishë dhe në popullin tonë.

-Në fakt le ta nisim këtë rrugëtim që nga largimi juaj nga Shqipëria, rikthimi në atdhe, emërimi si Ipeshkëv e deri më 22 janar të këtij viti ku Ju filluat misionin tuaj në krye të Kishës katolike si kryepeshkëv i ri. Si mund ta përshkruani ju këtë cikël të jetës suaj?

Ne shohim gjithmonë e më shumë në ecjen tonë, duke kthyer kokën mbrapa, duke parë

ekzistencën tonë, shohim në të vërtetë se vetëm Zoti mund të jetë autori i ecjes sonë. Ne kemi lirinë dhe vendosmërinë për të thënë po ose jo Zotit. Por në momentin që i themi Po, edhe nëse rrezohemi, edhe nëse ne ndalemi, edhe nëse ne njëfarë mënyre hasim shumë pengesa, Zoti është pranë nesh, na jep dorën, na tërheq, na udhëheq e na shoqëron në atë që ai ka menduar që në amshim për ne. Edhe në këto etapa duke menduar faktin e ikjes në Itali, unë kurrë se kam imagjinuar që do bëhesha prift, por ja që në takimin me një pervojë të gjallë të fesë kam takuar fenë në personin Jezu Krishtit.



Feja për ne është shumë praktike, konkrete siç dëfton edhe misteri i Krishtlindjes, ku fjala e Zotit bëhet mish, pra me praninë e Krishtit në gjrin e virgjeres Mari. Dhe e merr këtë prani në jetën secilit prej të krishterëve nëpërmjet Pagëzimit bëhet e prekshme e dukshme. Ne jemi më të vërtetë “kristoforo”, pra përcjellës edhe përmbajtës të Krishtit. Kjo është për mua e domosdoshme në vetëdijen time sepse e ndiej kudo që takoj një person, takoj një imazh, një ngjashmëri të Hyjit dhe kjo me vendos përballë faktit që po i shërbej Zotit.

Gjëja tjetër është fakti se dhe në etapat historike të ekzistencës tonë, janë disa data e disa momente që mendojmë që i zgjedhim ne, por në të vërtetë Zoti i ka bërë ato të rëndësishme për ne. Përshebull më 30 Nëntor të vitit 1997, kam hyrë në seminar kur kam filluar jetën time në formimin për meshtar në komunitet. Dhe më 30 Nëntor 2021 është publikuar emri im si Arqipeshkv. Pra janë gjëra që Zoti në njëfarë mënyre në historinë e secilit prej nesh i shënon që historia jonë të mos jetë thejst një histori kalimtare njerëzore por të bëhet me të vërtetë një histori hyjnore për amshim.

-Me emërimin tuaj si Arqipeshkvi i Metropolitan i Tiranë-Durrës është hapur një faqe e re në jetën e Kishës Katolike. Tashmë pothuajse një

vit në drejtimin e saj, cilat janë sfidat por dhe sadisfaksionet si Bari i kësaj kishë?

Për neve si katolikë, është gjithmonë e domosdoshme vetëdija që jemi të thirrur të jemi në ecje. Jezusi vetë na thërret e na thotë: “Kush do që të vije pas meje, të marri kryqin e vetë, të mohojë vetveten e të më ndjek”. Pra sfidën më të madhe çdo katolikë dhe une akoma më shumë e kam para së gjithash me veten time, që çdo ditë të ripërtërij vendosmërinë time për ti shërbyer kësaj kauze. Pra jo kauzës time, jo lavdisë time për tu zhveshur nga çdo formë narcisizmi që

shoqëron kur ndonjëherë kemi vende që janë të thirrur të jenë për shërbim por mund të bëhen pastaj role pushteti, e pra kjo është shumë themelore.

Pastaj llogjike e aspektit të misionit tim për mua para së gjithash është të ripërtërij premtimet pagëzimore, pra që katolikët shqiptarë të kuptojnë që janë të thirrur të jenë manifestimi i Krishtit duke jetuar premtimet pagëzimore. Pra duke u sjellë si Krishti në Besojmë. Besojmë në Jezu Krishtin, besojmë në Kishën, besojmë në Hyjin Atë, besojmë në Shpirtin e Shenjtë. Dhe këtë duke e sjelle me veprat e dashurisë. Pra është themelore të rithellojmë vetëdijen tonë e të qenurit bijtë e Hyjit. Në të njëjtën kohë të nxisim sa më shumë vëllezër e motra që po kërkojnë Krishtin që nëpërmjet Pagëzimit me të vërtetë hyjnë në familjen hyjnore.



-Përshtetësisht më kanë dhënë një ndjesi emocionuese fjalët që ju keni zgjedhur si moto ipeshkëvnore, “Qe Nëna jote!”.

Përtej simbolikës religjioze që ajo mbart, me ngjan si një “himn” që ju ia dedikoni nënave shqiptare ...

Ne e dimë shumë mirë se çdo familje është e bukur e ëmbël, e fortë përballë çdo sfide varfërie ose situatave të tjera të vështira që mund të hasë, është një Nëne me një zemër të madhe në këtë familje. Ne jemi pra, së pari të thirrur nëpërmjet zemrave të nënave. Të jetojmë atë që Papa Françesku na thotë “revolucionin e butësisë”. Nuk bëhet asgjë, as me forcë, dhunë apo të bërtitura, por me një zemër nënë ndryshojnë shumë gjëra. Mos të e harrojmë, të gjithë jemi bijtë nënash si i miri e si i keqi. Por po të rikthehemi në gjenezën e takimit tonë, ne familjen ku jemi formuar kuptojmë që Zoti dëshiron nëpërmjet zemrës së nënës të na riktheje fëmijë për tu rikthyer pikërisht në vlerat e bukura që kishim atëherë e që mund ti rikuperojmë akoma sot. Të mësojmë në shkollën e dashurisë së një nëne si Maria, e të mësojmë ta duam më shumë njëri-tjetrin.

Edhe kur nuk arrijmë ta duam më shumë njëri-tjetrin, të dëmtojmë se “Qe Ja Nëna Jote”, ajo të rikthen në atë që je thirrur në këtë jetë.

-Medjugorje në Tiranë! Një organizim i jashtëzakonshëm nga Arqidioqeza Metropolitane Tiranë-Durrës bëri bashkë mijëra besimtare pa dallim feje në Festivalin e “Lutjes dhe të Paqes”. Në fakt duket se sot kemi nevojë më shumë se kurrë për lutje për paqe ndërsa një luftë e paprecedent prej disa muajsh po zhvillohet në

Ukrainë. Pse kaq e vështirë rendi dhe paqja mes njerëzve Imzot?

Festivali i Medjugores në Tiranë, pikërisht festivali i Lutjes dhe Paqes ka qenë me të vërtetë një dhuratë e Zotit që ka lindur nga ato takime që Zoti krijon për ne njerëzit në mënyrë rastësore për atë në mënyrë “provanie” që njerëzit të kenë mundësinë të dëgjojnë zërin e Zotit. Jo vetëm pra neve të na dëgjojë Zoti, por ne të dëgjojmë zërin e Zotit. Kjo ka qenë përvoja e këtij festivali, ku sikundër e përmendët edhe ju, ka qenë me dyer të hapura për të gjithë.

Përvoja e paqes dhe përvoja e lutjes është një përvojë bekimi për çdo njeri të çdolloj feje qoftë ai, dhe kjo përvojë atë ditë u perceptonte në mënyrë të gjallë falë edhe momentit të lutjes, momentit të bashkëndarjes edhe të njerit prej këtyre që vijnë nga përvoja e Medjugores ku në 1981 Zoja ka filluar ti deftoje Ivan Dragicevic. Dhe kjo përvojë ka qenë për ne konfirmimi i një diçkaje themelore. Siç më thoshte dhe vetë Ivan: “Zoja Mari kurrë nuk e ka braktisur këtë popull”, dhe këtu e tregon praninë e saj në mënyrë të dukshme. Dhe për ne është e sintetizuar kjo prani e dukshme e Zojës nëpërmjet rikthimit në kult të kësaj statuje e cunguar por me një fytyrë të ëmbël e një veshtrim depërtues neve të gjithë e mbajmë si simbol të pranisë së saj midis nesh.

Kjo përvojë lutjeje për mua ka qenë nxitëse që në momentin e parë kur Papa Françesku duke parë ngurtësinë dhe shkretëtirën e përgjigjes së liderve botërore për paqen që në



fillim në Ukrainë, atëherë ai bëri një apel ndaj gjithë Kishës, por jo veem Kishës, ndaj të gjithë njerëzve vullnetmirë që të mblidheshin më 25 mars e të bënin këtë akt kushtimi ndaj virgjëres Mari për të kërkuar paqen. Ftesë që dhe ne ua kemi bërë gjithë organizmave, sepse në mbarë botën ka nxitur që të ftoheshin njerëzit vullnetmirë për paqen. Dhe përballë lutjeve që njerëzit i bëjnë njëri-tjetrit për të pasur paqen duke gjetur këtë derë të mbyllur, atëherë kemi bërë apel Zotit që të gjejmë një derë të hapur që pastaj të trokase në zemrat e njerëzve. Kjo përvojë vijon akoma dhe fatkeqësisht kjo shkretëtirë është dëftim se çfarë ndodh në zemrat e njerëzve. Une mendoj se Ukraina është vetëm një valvul shfryrje e një konteksti që siç thotë Papa Françesku të “një luftë të tretë botërore që është e ndarë në pjesë në mbarë globin”.

– Imzot Dodaj, do doja të prekja dy momente të veçanta që ju keni sjellë për të gjithë besimtarët dhe jo vetëm. Përkujtimi i 70-Vjetorit të Meshës së Pashkëve në Tepelenë të kremtuar nga 5 priftërinj katolikë në 1952, dhe njekohesisht udheheqjen e meshës së Shenjtë në ambientet e ish-burgut të Spaçit, në Mirditë. Cilat ishin ndjesitë që provuat ndërsa

shkelnit në ato dy vende dëshmitare të tmerreve pafund që kanë përjetuar qindra fëmijë, burra e gra gjatë kohës së diktaturës komuniste?

Të dyja eventet janë të lidhura për mua me njëri-tjetrin. Se pari përsa i përket 70-vjetorit të kësaj meshe në Tepelenë, isha i ftuar nga Mons.Pelagine në këtë takim për kumtesën e këtij përvjetori dhe duke dëgjuar aty veçanërisht një burrë të moshuar dhe një grua për tmerret e atij kampi, duke lexuar më pas më shumë por njëkohësisht duke menduar dhe vetë se sa herë unë kam qenë në vizitë në Aushvic, në Dachau duke parë këto kampe të përqendrimit, mu duk e qartë përvoja e një diktature që është përpjekur të bëjë ndaj fesë që i jepte një shpresë në mes të errësirës që ndizte një dritë, do të jepte një arsye rimëkëmbje.



Pikërisht kjo diktaturë ka bërë gjithçka për ta shkukur këtë arsye shprese. Dhe aty në zemrën time u nxita nga fakti që sot në shoqërinë aktuale në brezat e rinj në Shqipëri, pothujase jo për faj të tyre po mungon ndoshta

“Përballë lutjeve që njerëzit i bëjnë njëri-tjetrit për të pasur paqen duke gjetur këtë derë të mbyllur, atëherë kemi bërë apel Zotit që të gjejmë një derë të hapur që pastaj të trokase në zemrat e njerëzve. Kjo përvojë vijon akoma dhe fatkeqësisht kjo shkretëtirë është dëftim se çfarë ndodh në zemrat e njerëzve. Une mendoj se Ukraina është vetëm një valvul shfryrje e një konteksti që siç thotë Papa Françesku të “një luftë të tretë botërore që është e ndarë në pjesë në mbarë globin”.

një program ose një strategji kujtese, nuk kanë fare vetëdije se çfarë realisht përmban e kaluara e vonë e popullit tonë, që është dhe arsyeja pse ne ndodhemi në këtë situatë. Pra nëse nuk kthehemi për të vënë re çfarë ka ndodhur, nëse nuk e rifreskojmë kujtesën tonë, ne do të rrezikojmë të bimë sërish të gabimet e së kaluarës. Për këtë arsye, duke qenë se jam dhe Presidenti i Komisionit për Formimin e Meshtarve, mendova që të paktën neve si kishë katolike të rizbulojmë këtë përvojë dhe vura re që as gjithë meshtarët bashkë nuk kishin bërë një takim sëbashku



në Spaç. I nxitur nga kjo dëshirë që të paktën të bënim sëbashku këtë përvojë në ato burgje ku shumë meshtarë, paraardhës tanë kanë dhuruar, sakrifikuar, ngujuar ekzistencën e tyre.

Dhe në bashkëpunim me Mons. Gjergj Meten kemi mundur të organizojmë këtë event në takim me gjithë meshtarët. Ka qenë me të vërtetë një përvojë e një krentimi në ferr ku sundon dhe fiton Drita, sundon dhe fiton Jeta. Por nëse nuk marrim vetëdije që ferri ekziston do të thotë që ne nuk po jetojmë. Sepse e bëjmë normale ferrin që kemi jashtë. Ndaj disa situata janë shumë themelore për të rizbuluar vlerën që ka jeta, që ka liria që ka dashuria, dinjiteti i njeriut etj.

-Përkundrejt vuajtjeve që populli shqiptar ka përjetuar përgjatë komunizmit, ende sot jemi përballë fenomeneve vertet shqetësuese siç është largimi i të rinjve. Kujtoj se vetë Ju e Ipushkinjtë e Shqipërisë, pak muaj më parë denoncuan njëzëri fenomenin e rendë të shpopullimit. Duket se ka humbur shpresa në Shqipëri? Pse po ikin sot shqiptarët?

E vertet, jo duket, por është e preکشme që fatkeqësisht brezat e rinj por jo vetëm të të rinjtë por te shumë familje kerkesa e parë që njerëzit përpiqen ti japin përgjigje është fakti i një

zhvendosje nga këtu. Fakti i një kërkimi të një stabiliteti gjetke, gjithmonë jashtë Shqipërisë. Kjo është shumë dramatike. Pse, sepse na bën të harrojmë vetëdijen se asnjë nuk e njih akoma vendin e vet dhe asnjë nuk e njih akoma mirë popullin e vet. Më e mira dhe për ne, nuk do të bëhet kurë jashtë, më e mira do të behet midis edhe sfidave që ka nevojë koha jonë të rimëkëmbjes së asaj që është vlera që ti je këtu. Nëse ne nuk jemi të vetëdijshëm që vlera që ti je këtu nuk do të jete kurrë tjetërkund, mund të jetë momentale por sdo të jetë kurrë shkëmbyese për ty të një ngrohësie të një dashurie të një statusi më familjar që këtu sidoqofte po braktis. Unë mendoj që

Familja është një realitet që ne e kemi marrë si dhuratë nga Zoti. Nuk jemi ne që mund ta transformojmë apo derformojmë një realitet duke i dhënë emrin familje. Familja ekziston pavarësisht ideve tona dhe është ajo natyrale, që është e themeluar në Babain dhe Nënë, Burrin dhe Gruan, që janë pikërisht ata që janë të thirrur për të rithemeluar jetën, për të dhënë vazhdimësi gjinisë njerëzore.



ka dhe shumë pak informacion. Pse, sepse shumë që shkojnë, falimentojnë, nuk kanë kurajon të kthehen e të shpjegojnë se çfarë ka ndodhur, dhe kjo është shumë themelore. Fenomeni i emigrimit është fenomen që i përket natyrës njerëzore, ka ekzistuar që në kohet e lashta, dhe vetë libri i Shenjtë është i mbushur plot me to. Por përshembull në librin e shenjtë kemi dhe fenomenin e kthimit. Ekso-di në token e premtuar. Mendoj se siç thashë mungon informacioni nga njëra anë, pra për të parë se çfarë po kërkujmë anej dhe për të ditur se çfarë do të gjejmë realisht. Dhe e dyta mungojnë sigurisht dhe politikat nxitëse të një rritje me të madhe të nivelit të jetesës. Sepse është i vërtetë fakti që nëse ne jemi të varfër, nuk do të thotë që fëmijët tanë në mënyrë të barabartë kanë të drejtë të zgjedhin të njëjtën shkollë pavarësisht mundësive ekonomike. Kjo nuk do të thotë që neve kemi te njëjtat kushte të asistencës shëndetësore pavarësisht mundësive ekonomike që kemi.

Duhet të ndërthuret ndryshe dhe shoqëria jonë këtu, përndryshe po braktisim diçka që ka më shumë vlerë por që nuk ia kemi dhënë shansin për të zbuluar thesarin që ka ky vend.

-Një tjetër sfidë me të cilën po parballet shoqëria jonë, (besoj jo vetëm ajo shqiptare), është familja. Familja shqiptare është në rrezik. Çfarë mund të bëjë Kisha katolike në konsolidimin e kësaj hallke ekzistenciale të shoqërisë sonë?

Me hirin e Zotit ne kemi arritur deri në këtë kohë me një familje

të fortë me vlerat e përkatësisë ndaj familjes në identitetin e saj. Babi, Nëna, fëmijët, rrethi i ngushtë, rrethi i kushërinjve sikur të ishin vëllai, motra. Tani dhe shpërngulja, emigrimi por jo vetëm, fakti i të shkuarit larg apo tjetërkund por dhe fakti i thithjes së disa nocioneve ndryshe të konceptit të familjes na bën ndonjëherë të paragjykojmë atë që është koncepti i real i familjes natyrore. Familja është një realitet që ne e kemi marrë si dhuratë nga Zoti. Nuk jemi ne që mund ta transformojmë apo derformojmë një realitet duke i dhënë emrin familje. Familja ekziston pavarësisht ideve tona dhe është ajo natyrore, që është e themeluar në Babain dhe Nënë, Burrin dhe Gruan, që janë pikërisht ata që janë të thirrur për të rithemeluar jetën, për ti dhënë vazhdimësi gjinisë njerëzore. Kjo është shumë themelore sepse po e humbi këtë ABC nuk mund të vijojmë dialogun për te ardhmen e shoqërisë, për të ardhmen e njerëzimit.



Në aspektin tjetër shumë themelore është të kthehemi te fakti që një familje ka nevojë të ketë një mbështetje që të jetë familje, përndryshe ne rrezikojmë të kemi familje që fatkeqësisht janë shumë të mjera, të sprovuara, të shtypura, të harruara.

Mrekullia e Krishtlindjes është kjo, që me kalimin e shekujve është festa e të gjithëve. Kështu që me të vertetë mesazhi për të gjithë është që po na vjen një fëmijë. E kur vjen një fëmijë pavarësisht kushteve që ndodhet ajo familje ose lagjia ku jeton, ajo familje dhe ajo lagje do të jetë më e pasur dhe më e paqtë.

Si mund të quajmë familje, ku nuk mund të ketë një çati mbi kokë, ndoshta nuk do ta ketë me luksin që ka një i pasur por sigurisht ai që ka marrë më shumë ka detyrimin moral dhe social që një pjesë e gjithë atyre pasurive të sprocionuara ti përkasin dhe ketyre familjeve më të varfëra. Dhe të pasurit duhet ta dinë se janë thjeshtë administra-

tor të të mirave të tyre, jo pronar pasi atë pasuri e kanë bërë në një tokë që u përket të gjithëve.

-Po politika shqiptare? Çfarë mund të bëjë ajo më shumë. A keni ju një mesazh për politikanët shqiptarë?

Politika shqiptare, unë mendoj mbi të gjitha që duhet të bëjë politikë, që është shumë themelore. Politika shqiptare duhet në njëfarë mënyre ta rielaborojë pak gjuhën me të

cilën trajton realitetin e tyre të brendshëm. Politika shqiptare ka shumë nevojë që të zbulojë që është në shërbim të “polis” dhe jo të “egos”. Politika shqiptare ka nevojë mbi të gjitha të kuptojë që është politikë dhe jo biznes. Politika shqiptare ka nevojë që të kuptojë që vlerat për të cilat është e thirrur që ti mbrojë nuk niset nga interesi monetar por mbi të gjitha nga interesi më i madh, që është atij i kombit, i vendit. Interesi i kombit shkon mbi interes individual. Politika shqiptare duhet të zbulojë që nuk është një investim të futesh në politikë por është një shërbim, siç thoshte Pali VI-të që politika është mënyra më lartë e dashurisë.

-Imzot Dodaj, Kisha Katolike po kremton Kohën e Ardhjes që shënon dhe lajmërimin e Lindjes së Krishtit. Cili është mesazhi juaj për besimtarët katolikë por dhe për të gjithë popullin Shqiptarë në prag të Krishtlindjes dhe ndërrimit të motmoteve?

Mrekullia e Krishtlindjes është kjo, që me kalimin e shekujve është festa e të gjithëve. Kështu që me të vertetë mesazhi për të gjithë është që po na vjen një fëmijë. E kur vjen një fëmijë pavarësisht kushteve që ndodhet ajo familje ose lagjia ku jeton, ajo familje dhe ajo lagje do të jetë më e pasur dhe më e paqtë. Kështu që urimi im, është pasurojmë këtë Krishtlindje aqoma më shumë veçanërisht në njerëzi.

Të rizbulojmë paqen, që ndoshta nuk po arrijmë ta kemi në Ukrainë por të pakten të rizbuloj, ta vlerësojmë e ta thellojmë midis nesh këtu në Shqipëri.

Dialogu në “koma artificiale”! Katari futbollistik, katran demokratik! Klima midis krizës dhe katastrofës! Ballkani i Hapur” non – grata” dhe në Bruksel!

REALPOLITIK “FLASH” NO. 58

17 – 30 NENTOR 2022

EKSKLUZIVISHT PER ARGUMENTUM

Shkurt dhe Shqip mbi 4 ngjarjet kryesore diplomatike me vetëm 1000 fjalë nga analisti i njohur diplomatik

DR. JORGJI KOTE *MJESHTËR I MADH*

1. Dialogu në “koma artificiale”! Po, pavarësisht nga eufemizmat diplomatikë, dialogu Prishtinë – Beograd vazhdon të jetë në “koma artificiale”! Mirëpo, tani, 11 vjet as fillimit të tij dhe rezultateve minimaliste nuk mban më ujë pilafi” Ndaj SHBA-ja dhe BE-ja i kanë intensifikuar demarshet diplomatike në rajon dhe midis dy palëve. Është shtuar numri i ndërmjetësuesve, tani ka BE-ja, SHBA-të Britania e Madhe, Gjermania, dhe Franca. Në vend të diplomacisë reale klasike po shihet më shumë “diplomacia e krizës dhe e “ec e jakeve”, ku dhe ndërmjetësuesit janë në rolin e “zjarrfikësve diplomatikë” duke vrapuar sa andej këndeje për të shuar zjarret në rajon; dhe këtu, siç tregoi takimi i 21 Nëntorit Vuçiç – Kurti në Bruksel “ka ngecur sharra në gozhdë”.

Pas 8 orë negociatash në praninë e Borrell dhe Lajçak demarshet për uljen e tensionit me rastin e konvertimit të targave të makinave serbe në Kosovë dështuan. Madje, Vuçiç dhe Kurti nuk e panë njeri tjetrin në sy, dhe as shtrënguan duart. U deshën dy ditë të tjera negociatash të



vështira për të arritur dakordësimin më 23 Prill. Kemi shkruar vazhdimisht se dialogu Prishtinë – Beograd është në qorr-sokak dhe se tani për tani nuk bëhet më fjalë për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare, por thjesht për të shuar flakët e krizave të njëpasnjëshme. E kuptueshme kjo përderisa BE dhe SHBA vazhdojnë ta mbajnë Serbinë “me hatër” duke i trajtuar Beogradin dhe Prishtinën “njerin si të nënës dhe tjetrin si



të njerkës”! Ndaj, ka ardhur koha që kjo praktikë të marrë fund. Gjithsesi, le të shpresojmë, edhe

pse “siç duken bathët”, vështirë se mund të bëhet gjë, të paktën në një afat të parashikueshëm kohor.

2. Katari futbollistik katran demokratik! Padyshim që çelja e Kampionatit Botëror të Futbollit në Katarin e shumë diskutuar ishte ngjarja më e madhe e këtyre dy javëve për të gjithë. Futbolli është magjia që të rrëmben pa e kuptuar. Ai bashkon të gjithë dhe të gjitha, pa asnjë dallim në festë dhe gëzime. Mirëpo, ja që ky Katar është kthyer në një “katran me bojë” përse i përket respektimit të vlerave demokratike, të drejtave universale të njeriut, tolerancës, pakicave, të grave, orientimeve të ndryshme gjinore, etj.

“Tersi” filloi qysh me trajtimin çnjerëzor të puntorëve që ndërton stadiumet dhe impiantet e tjera gjigande, ku raportohet se kanë vdekur dhe rreth 500 puntorë; ai

vijon tashmë me kufizime, ndalime dhe dënime ligjore në rastet e ushtrimit të të drejtave njerëzore. Debatet lidhur me simbolin “Një dashuri” që u anulua dhe të tjera dukuri negative natyrisht që kanë hedhur hije të mëdha dyshimi në vlerat dhe imazhin e këtij Botërori. Mirëpo, zhurma e madhe për përfaqësimin dhe mbrojtjen e këtyre vlerave themelore njerëzore Perëndimore, duke filluar nga SHBA-të, Gjermania, Franca dhe Britania e Madhe tingëllon hipokrizi dhe demagogji.

Sepse fakti që Katari nuk është demokraci liberale dihej nga të gjithë. Mirëpo, mesa duket, interesat ekonomike, paraja dhe fitimi i spostojnë vlerat dhe parimet demokratike. Ndryshe, siç theksohet në median e huaj, nëse këto vende ishin të interesuar për mbrojtjen dhe përfaqësimin e vlerave më të mira demokratike, fare mirë të paktën mund të kishin këmbëngulur për simbolin “Një dashuri” ose dhe të ishin tërhequr nga kjo veprimtari. Rol negativ këtu luajtën dhe personalitete të artit, muzikës dhe sportit botëror me në krye FIFA dhe Presidentin e saj Infantino. Për fat të keq, veç zbehjes së interesit dhe vlerave sportive, Katari do të mbetet në histori si një shembull i qartë kur paraja, fitimi komercial “blejnë” gjithçka, ato nuk blejnë vetëm gazin dhe energjinë, siç bëri Gjermania me Katarin keto ditë; por ato blejnë dhe parimet & vlerat demokratike, duke i nxjerë ato “jashtë loje”. Gjithçka tjetër janë fjalë boshe dhe “furtunë në një gotë çaji”.

3. Klima midis krizës dhe katastrofës mbeti dhe pas

përfundimit të Konferencës Botërore të Klimës COP 27 në Sharm El Sheik në Egjipt. “Shpëtimtarët” siç i cilësuan në rubrikën tonë të mëparshme 30.000 pjesëmarrësit e saj nuk e justifikuan besimin e dhënë. Gjithçka u reduktua te Marrëveshja mbi krijimin e fondit fi-



nanciar për mbulimin e kostove dhe dëmeve nga fatkeqësitë natyrore; por dhe kjo arritje jo e vogël, pa afat dhe hollësi të tjera lidhur me shumën dhe shpërndarjen e këtyre fondeve. Sa për masat e tjera për të mos lejuar ngritjen e temperaturave mbi 1,5 gradë dhe reduktimin e lëshimit të gazrave karbonikë, veç fjalëve dhe zotimeve asgjë në shportë. Ndaj mendimi i përgjithshëm mbi rezultatet e COP27 ishte “shumë vonë dhe shumë pak”. Sërish klima dhe bota ndodhen midis krizës dhe katastrofës, pa shumë shpresa te politika.

Një goditje kjo për lëvizjet politike të Gjellëra që kishin ngjallur shumë pritshmëri, falë angazhimit të tyre të madh. Padyshim më e shquara është Ministrja e Jashtme gjermane, Zonja Baerbock, lidere e Partisë së Gjellër që u kthye duarbosh dhe e zhgënjyer nga Egjipti. Për pasojë, tani vihet në dyshim realizimi i objektivave të Konferencës së Parisit 2015. Ndaj dhe COP 27 rezultoi “shumë zhurmë

për pak gjë”

4. Ballkani i Hapur “non grata” në Bruksel! Kështu mund të thuhet pa hezitim pas miratimit me shumicë dërmuese votash në Parlamentin European në Bruksel më 23 Nëntor mbi Procesin e Zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Aty u shpreh hapur kundërshtimi ndaj Ballkanit të Hapur, si nismë jo gjithëpërfshirëse që shpërfill vlerat dhe interesat e BE-së. Dajak të fortë në këtë Rezolutë dhe për nismëtarin e tij, Beogradin zyrtar, duke ia venë “të dyja këmbët në një këpucë”. Plus, kërkesës së fortë, që përparimi i Serbisë drejt BE-së të matet dhe shqyrtohet në vartësi të qëndrimeve të saj ndaj Rusisë, linjëzimit me politikën e BE-së dhe përparimit në dialogun me Kosovën. Kësisoj, pas Berlinit dhe Parisit më 3 Nëntor në Samitin e Procesit të Berlinit në Berlin, “Balkani i Hapur” u shpall “non – grata dhe në Bruksel, si kryeqyteti” i BE-së së Bashkuar.



Lajm jo i mirë për mazhorancën tonë, e cila në fakt kishte paralajmëruar dhe priste shpalljen “non – grata” të ish Presidentit Berisha. Mirëpo Tirana nuk do të dëgjojë dhe vazhdon si “kokëmushkë” në të sajën. Të tjerat, përfshi dhe ceremonitë e përbashkëta tingëlluese mbeten në kuadrin festiv, folklorik dhe llafeve boshe.

“Korrupsioni Gërryen Potencialin e Shqipërisë”



Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të intensifikojnë përpjekjet tona për t’u përballur me korrupsionin dhe për t’iu kërkuar llogari aktorëve të korrumpuar. Pse? Sepse ne duam ta shohim Shqipërinë – mike dhe aleate e jona në NATO – të rritet më e fortë dhe më e pasur. Korrupsioni përbën një çënueshmëri të sigurisë kombëtare, kufizon dhe shtrembëron investimet, si dhe minon demokracinë.”

Lexoni të plotë editorialin “Korrupsioni Gërryen Potencialin e Shqipërisë”,

Nga Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara Yuri Kim

Teksa shënuam Ditën Ndërkombëtare Anti-Korrupsion dje, është me rëndësi që të rigjallërojmë përpjekjet tona për t’i dhënë fund murtajës së korrupsionit. Korrupsioni iu vjedh qytetarëve dhe brezave të ardhshëm pasurinë dhe shpresën. Ai than rritjen ekonomike, pengon zhvillimin, minon demokracinë, si dhe iu hap dyert kriminelëve, trafikantëve dhe terroristëve.

Prandaj Presidenti Biden, për herë të parë, e përcaktoi anti-korrupsionin si interes thelbësor të sigurisë kombëtare dhe bëri publike një Strategji ambicioze të Shteteve të Bashkuara për t’iu Kundërvënë Korrup-



Ne financojmë reforma në drejtësi, përfshi me BE-në dhe partnerë të tjerë. Mbështesim median investigative dhe organizatat e shoqërisë civile që luftojnë korrupsionin. Përdorim shpalljet nongrata dhe sanksionet ndaj aktorëve të korruptuar dhe do të vazhdojmë ta bëjmë këtë. Për shembull, Presidenti Biden nënshkroi në qershor 2021 një Urdhër Ekzekutiv të ri, i cili përqendrohet te krijimi i kostove për ata që përfshihen në veprimtari që minojnë institucionet demokratike dhe destabilizojnë Ballkanin Perëndimor, përfshi në Shqipëri.

sionit. Për ta vënë në zbatim strategjinë, Shtetet e Bashkuara punojnë anëmbanë globit për të ndihmuar vendet që të parandalojnë ryshfetin, të mbështesin hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit, promovuar transparencën, si dhe fuqizuar shoqërinë civile dhe median e pavarur për të zbuluar korrupsionin.

Këtë javë, qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe Transparency International organizuan Konferencën e 20 Ndërkombëtare Anti-Korrupsion, të përqendruar te mbrojtja e vlerave demokratike nga korrupsioni. E vlerësojmë pjesëmarrjen e zyrtarëve të qeverisë, gazetarëve dhe përfaqësuesve të OJQ-ve në të, përfshi nga Shqipëria.

Shtetet e Bashkuara e mbështesin luftën kundër korrupsionit me veprime të qarta. Ne financojmë reforma në drejtësi, përfshi me BE-në dhe partnerë të tjerë. Mbështesim median investigative dhe organizatat e shoqërisë civile që luftojnë korrupsionin. Përdorim shpalljet nongrata dhe sanksionet ndaj

aktorëve të korruptuar dhe do të vazhdojmë ta bëjmë këtë. Për shembull, Presidenti Biden nënshkroi në qershor 2021 një Urdhër Ekzekutiv të ri, i cili përqendrohet te krijimi i kostove për ata që përfshihen në veprimtari që minojnë institucionet demokratike dhe destabilizojnë Ballkanin Perëndimor, përfshi në Shqipëri. Ky Urdhër Ekzekutiv është përdorur tashmë për të sanksionuar aktorë të korruptuar.

Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të intensifikojnë përpjekjet tona për t'u përballur me korrupsionin dhe për t'iu kërkuar llogari aktorëve të korruptuar. Pse? Sepse ne duam ta shohim Shqipërinë – mike dhe aleate e jona në NATO – të rritet më e fortë dhe më e pasur. Korrupsioni përbën një çënueshmëri të sigurisë kombëtare, kufizon dhe shtrembëron investimet, si dhe minon demokracinë.

I nxisim institucionet e drejtësisë të Shqipërisë që të bashkohen me ne për ta ngritur anti-korrupsionin si çështje qendrore – për të bërë të qartë

se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, që askush nuk është mbi ligjin, që ditët e pandëshkueshmërisë po i afrohen fundit, që populli Shqiptar mund të mbështetet tek institucionet shqiptare për të dhënë drejtësi, dhe që cilido ka një mundësi të drejtë dhe të barabartë për sukses në Shqipëri.

Institucionet shqiptare po bëjnë përparim kundër korrupsionit por ka shumë më tepër për të bërë. Lufta kundër korrupsionit është një proces i gjatë dhe i vështirë por suksesi është i mundur. Asnjë vend nuk ka imunitet. Secili vend, përfshi Shtetet e Bashkuara, e lufton korrupsionin çdo ditë. Sfida e Shqipërisë nuk është aspak unike – as nuk është e pakapërcyeshme.

Gjatë vitit të fundit, institucionet shqiptare kanë filluar të ndjekin penalisht çështje që më parë as nuk do ishin prekur. Uniteti ynë si aleatë në NATO ka arritur nivele të reja. Shqipëria ulet me Shtetet e Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Këtë verë, Shqipëria hapi bisedimet për anëtarësim me BE-në, një arritje e jashtëzakonshme që duhet ta bëjë krenar çdo shqiptar.

Gjatë këtij 100-vjetori të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike SHBA-Shqipëri, përkushtimi ynë ndaj popullit Shqiptar është më i fortë se kurrë. Rruga përpara – drejt anëtarësimit në BE, drejt drejtësisë – mund të jetë e vështirë, por Shtetet e Bashkuara mbeten të vendosura për të qenë në krahun tuaj çdo hap, në mënyrë që të ecim përpara së bashku. Gjithnjë përpara, gjithnjë bashkë.

Bosnje-Hercegovinë: Vend kandidat i BE falë gjeopolitikës

Bosnje-Hercegovina pret prej vitesh që të marrë statusin e vendit kandidat në BE. Tani BE për arsye gjeopolitike dha dritën e gjelbër. Cili është qëndrimi i politikanëve gjermanë?

Ka një kohë të gjatë që në politikën europiane, Bosnje-Hercegovina nuk luan më ndonjë rol. Tmerri i luftës së Bosnjes dhe gjenocidi në Srebrenicë janë harruar në masë të madhe dhe zbehur. Ky vend ndodhet prej kohësh në një paralizë politike, kartelet politike etno-nacionale të tre etnive, boshnjake, serbe dhe kroate pengojnë gati të gjitha reformat, njerëzit e braktisin vendin me shumicë. Në këto kushte as nuk mendohej më për integrimin europian sipas premtimit të para dy dekadave.

Por tani B-H është vend kandidat i BE. Në samitin e Brukselit, krerët e shteteve dhe qeverive europiane vendosën për këtë, gjashtë vjet pas ky vend aplikoi për anëtarësimin në BE, por nuk zbatoi asnjë nga reformat e kërkuara. Megjithatë pa asnjë dallim politikanët gjermanë e vlerësojnë pozitivisht këtë vendim, “si një sinjal shumë pozitiv për njerëzit në Bosnje-Hercegovinë” dhe një hap “që duhej të bëhej prej kohësh”. DW iu drejtua me pyetje ndër të tjera Boris Mijatovic (Të Gjëlbrit), Adis Ahmetovic dhe Jasmina Hostert (SPD) si edhe Thomas Hackerit (FDP) – katër politikanë që angazhohen për këtë rajon.

Arsye gjeopolitike

Asnjë nga politikanët nuk është i mendimit se dhënia e statusit kandidat është rezultat i progresit të zhvillimit institucional dhe demokratik të këtij vendi. Si arsye shikohet dimensionin gjeopolitik dhe shqetësimi për stabilitetin dhe sigurinë në



Europë. “Lufta agresore kundër së drejtës ndërkombëtare që nisi Rusia në Ukrainë ka sjellë dinamika të reja në politikën e fqinjësisë dhe zgjerimit në BE, të cilat pa këtë luftë nuk do të kishin këtë ritëm”, thotë Thomas Hacker, raportues i FDP-së për vendet e Ballkanit. “Tek kjo dinamikë bën pjesë pa dyshim edhe statusi i vendit kandidat për Bosnje-Hercegovinë.”

Edhe politiani i gjelbër, Boris Mijatovic është i mendimit se “kemi të bëjmë me një situatë gjeopolitike serioze, që u krijua dhe ashpërsua pas sulmit të Federatës Rusë ndaj një fqinji sovran.” Nëse BE nuk e bën realitet premtimin e saj, atëherë boshllëku do të mbushet nga vende të tjera si “Rusia, Kina apo të tjerë”, tha Mijatovic për DW. Deputeti socialdemokrat i Bundestagut, Adis Ahmetovic thotë se Ballkani Perëndimor duhet të “konsiderohet një rajon me rëndësi gjeopolitike dhe integrimi në BE duhet të çohet përpara.” Ahmetovic paralajmëron, se Ballkani nuk duhet të bëhet një portë e hapur për konfliktin tjetër në Europë.

Motivim për politikën e brendshme

Në të njëjtën kohë dhënia e statusit kandidat mund të kthehet në një impuls të madh për të zhvilluar më

tej demokracinë dhe shtetin ligjor në vend, theksojnë politikanët gjermanë. “Lidershipi politik i vendit duhet ta përdorë këtë vendim tani për të zbatuar reformat e nevojshme”, thekson politiani liberal, Thomas Hacker. “Statusi i vendit kandidat duhet të bëhet motivim për përpjekje edhe më të mëdha.”

Këtë e shpreson edhe Përfaqësuesi i Lartë për Bosnje-Hercegovinë, Christian Schmidt. Për DW ai tha se “ky është një shans unik për Bosnje-Hercegovinë. Statusi kandidat është një hap vendimtar për afrimin me BE dhe një të ardhme si vend anëtar i BE.” Por Schmidt paralajmëron, se ky vend duhet të jetësojë premtimin për t’u kthyer në një vend multietnik prosperues dhe të sigurtë për të gjithë shtetasit e vet. Politiani gjerman i CSU, Schmidt premtonte një angazhim më të madh të BE. Edhe deputetja e Bundestagut, socialdemokratja Jasmina Hostert është e mendimit që BE duhet të angazhohet më shumë në Bosnje-Hercegovinë. “Përpjekjet për reforma merren në konsideratë nga BE dhe ajo e mbështet Bosnje-Hercegovinë në tejkalimin e krizave që kemi në Europë.” Por tani është koha që fjalët të bëhen vepra. “Pas 20 vitesh perspektivë është koha për më shumë se hapja e një horizonti.” /DW

Zgjidhet kreu i ri i SPAK/ Ambasadorja Amerikane ndjek procesin nga afër

E gjithë vemendja mediatike, politike por dhe ndërkombetare në këtë 16 dhjetor është te gara për kreu e ri të Prokurorisë së Posaçme.

Pikerisht këtë të premte, Prokuroria e Posaçme do të bëhet me një kryetar të ri. Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të votojë për të zgjedhur pasuesin e Arben Krajës për një mandat trevjeçar, mes tre emrave, Adnan Xholi, Altin Dumani dhe Edvin Kondili.

Para votimit, kreu në ikje i SPAK, Kraja, postoi një foto në llogarinë e tij në Twitter me të tre kandidatët. “Suksese kandidatëve për Drejtues! SPAK do të vazhdojë të përmbushë detyrimet ligjore me efektivitet edhe më të lartë”, shkroi Kraja.

Në fjalën e tij në nisje të seancës, kryetari i KLP-së, Alfred Balla tha se tre vite më parë ky këshill zgjodhi kryetarin e parë të SPAK, mes 8 anëtarëve themelues të kësaj strukture.

“Sot jemi përsëri të kryejmë detyrën tonë kushtetuese për të zgjedhur një drejtues të ri me mandat 3-vjeçar. Mandati i kreut të SPAK, Arben Kraja mbaron më 18 dhjetor 2022 dhe e falënderoj për drejtimin dinjitoz”, u shpreh ai.

Duke iu drejtuar tre kandidatëve për kreun e SPAK, Adnan Xholi, Altin Dumani dhe Edvin Kondili, Balla tha se “do

